



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 04.10.2022

NJOFTIM

NJOFTIM MBI VIJËN E FINANCIMIT NË MASËN 7.1 MBËSHTETJE PËR KULTIVIMIN E GRURIT

Bazuar në VKM Nr. 556, datë 29.7.2022 për disa shtesa dhe ndryshime në VENDIMIN nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve, që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 14, datë 01.08.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 1, datë 11.02.2022 "Për, kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" të ndryshuar, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton shpalljen e aplikimeve fituese për Masën 7.1 "Mbështetje për kultivimin e grurit" si më poshtë:

- **Masa 7.1:** Mbështetje për kultivimin e grurit - Të gjithë fermerët që janë përzgjedhur fitues dhe janë brenda fondit të alokuar për këtë masë, do të njoftohen individualisht me mesazh automatik në portalin e-Albania, në rubrikën “Mesazhet e mia”.

AGROPIKAT janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda fondit të alokuar në këtë masë.

Aplikantët të cilët do të njoftohen, kanë afat 15 ditë kalendarike për të dorëzuar dokumentacionin e tokës bujqësore që kanë në pronësi dhe/ose përdorim.